



Deklarata e Misionit të FMN-së për Shqipërinë

Tiranë, 11 Nëntor, 2008

Kjo deklaratë paraqet përfundimet e misionit të FMN-së që vizitoi Shqipërinë në 29 tetor - 11 nëntor 2008, për të diskutuar me autoritetet rishikimin e gjashtë dhe të fundit të marrëveshjes PRGF/EFF.

Ekonomia shqiptare në 2008 ka ecur mirë deri më tani. Inflacioni është rikthyer brenda kufirit të synuar të Bankës së Shqipërisë 3 ± 1 përqind, ndërkohë që rritja ka mbetur e fortë dhe është në rrugën e duhur për të arritur përsëri rreth 6% këtë vit. Konsolidimi i borxhit ka vazhduar dhe pozicioni i jashtëm bazë është i shëndetshëm, pasi rritjet e kohëve të fundit të deficitit të bilancit të pagesave pasqyrojnë kryesisht faktorë të përkohshëm.

Kjo ecuri e favorshme është përforcuar nga politika makroekonomike dhe strukturore përgjithësisht të shëndetshme, të cilat kanë hedhur themelet për përfitime në të ardhmen. Normat e interesit janë mbajtur në mënyrë të vazhdueshme mbi inflacionin, politikat buxhetore kanë mbështetur stabilitetin makroekonomik dhe rregulloret e mbikqyrjes së sistemit bankar janë forcuar dhe përditësuar dhe ka patur përmirësime të qarta në klimën e biznesit. Megjithatë, rritja e të ardhurave tatimore është ngadalësuar tani. Gjithashtu, ka nisur me sukses privatizimi i kompanisë së shpërndarjes së energjisë, megjithëse pozicioni financiar i KESH-it është duke u përqësuar përsëri.

Me një përkeqësim të mprehtë të prespektivës së rritjes ekonomike botërore që tashmë ka filluar (*shih* <http://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2008/update/03/>) është e rëndësishme që politikbërësit shqiptarë të forcojnë më tej themelet ekonomike. Integrimi i kufizuar i Shqipërisë në tregjet botërore në këtë situatë siguron një mbrojtje të rëndësishme, por ekonomia nuk është e paprekshme: rritja e eksporteve pritet që të ngadalësohet nga nivelet e larta të kohëve të fundit, dërgesat e emigrantëve mund të ndikohen dhe investitorët mund të rivlerësojnë rreziqet. Natyrisht, qeveria nuk mund të ndikojë në ngjarjet e jashtme botërore, por mundet dhe duhet të ndërmarrë hapa shtesë për të rritur besimin në vend, pasi në klimën aktuale politikat është më mirë të jenë më të matura se ç' duhet. Kjo do t'i mundësonte Shqipërisë t'a kalonte furtunën e këtyre kohëve të turbullta dhe përsëri të regjistronte një rritje ekonomike domethënëse midis 3.5 dhe 4 përqind në vitin 2009, me një inflacion të ulët dhe me një pozicion të përmirësuar të llogarisë korrente.

Në këtë moment, politika fiskale ka një barrë veçanërisht të rëndë. Për vitin 2008, misioni këshillon një rishpërndarje të shpejtë të shpenzimeve për të siguruar që sektorëve prioritarë po i kushtohet rëndësia e nevojshme dhe njëkohësisht që defiçiti të kufizohet në 5.2 përqind të PBB-së. Në të ardhmen, misioni rekomandon që të ruhet defiçiti në vitin 2009 nën 4 përqind të PBB-së. Ky konsolidim i pozicionit fiskal do të forcojë besimin, do të rrisë qëndrueshmërinë e borxhit dhe do të kufizojë ngushtimin e aksesit në kredi të sektorit privat. Projekt-buxheti—së bashku me një rritje të pritshme të tarifës më shumicë të energjisë së KESH-it dhe shtyrjen e parashikuar të uljes së normës së kontributeve të sigurimeve shoqërore për në 1 maj 2009—është në përputhje me këtë synim. Përveç domosdoshmërisë makroekonomike, misioni do të rekomandonte që çdo ulje në normat e sigurimeve shoqërore, të presë një reformë të gjerë të pensioneve, që do të forconte lidhjen midis kontributeve dhe përfitimeve dhe do të jepte shtysa të rëndësishme për vetë-zbatim. Kjo do të ndihmonte luftën kundër informalitetit dhe do t'i lejonte autoritetet që të mbështeten më pak në rregulloret administrative penguese që aktualisht krijojnë hapësirat të konsiderueshme për interpretim dhe korrupsion. Pas përfundimit të programit të FMN-së, i nxisim autoritetet që të angazhohen për zbatimin e një rregulli fiskal të qartë për të ankoruar politikat buxhetore, si p.sh. një kufi të përshtatshëm



INTERNATIONAL MONETARY FUND
RESIDENT MISSION IN ALBANIA

për shpenzimet, defiçitin ose borxhin publik.

Inflacioni pritet të mbetet brenda objektivit të synuar duke qenë se pritshmëritë për inflacionin janë të ankoruara mirë dhe presioni nga çmimet botërore të ushqimeve dhe të energjisë është ulur. Banka e Shqipërisë duhet të vazhdojë të jetë e gatshme për t'iu kundërvënë çdo përkeqësimi në pritshmëritë për inflacionin, përfshirë këtu edhe nëpërmjet rritjes së normës së interesit. Me një sistem bankar solvent, likuid dhe me fitim, pritet që prirjet botërore të ndihmojnë në ngadalësimin e rritjes deri më tani shumë të shpejtë të kreditimit të brendshëm, çka ka përbërë shqetësim në të shkuarën. Pavarësisht nga kjo, është e rëndësishme që autoritetet të vazhdojnë përpjekjet e tyre për të forcuar regjimin rregullator dhe të mbikqyrjes për të ruajtur më tej stabilitetin e sektorit financiar.

Fillimi i suksesshëm i procesit të privatizimit të kompanisë së shpërndarjes së energjisë elektrike është inkurajues, por zhvillimet e fundit të pakënaqshme në sektorin e energjisë elektrike duhet të zgjidhen me shpejtësi. Norma efektive e arkëtimeve duhet të rritet më tej, mospagimi nga institucionet publike duhet të ndërpritet dhe humbjet financiare duhen adresuar më gjerësisht. Importet shtesë mbi nivelin e parashikuar në Planin e Veprimit do të krijojnë humbje të tjera dhe nëse ato vazhdojnë, tarifat efektive duhet të ngrihen. Gjithashtu, duke marrë parasysh përfundimin e pritshëm të procesit të privatizimit, do të jetë e rëndësishme që kontrata përfundimtare të mos krijojë asnjë hapësirë për pretendime kontigjente ndaj buxhetit në të ardhmen. Për të parandaluar vonesa të panevojshme në procesin e privatizimit, është e rëndësishme që Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjisë, të marrë përgjegjësinë kryesore.

Ne i mirëpresim përpjekjet e fundit për të përmirësuar statistikatat kombëtare dhe e inkurajojmë INSTAT-in të vazhdojë të përdorë mirë asistencën teknike në këtë fushë.

Pritet që rishikimi i gjashtë dhe i fundit nën programin aktual PRGF/EFF t'i paraqitet Bordit Ekzekutiv të FMN-së përpara përfundimit të marrëveshjes në datën 31 janar 2009.

Misioni dëshëron të falenderojë autoritetet për bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm dhe për mikpritjen e ngrohtë.

Gerwin Bell
Shef Misioni

Ann-Margret Westin
Përfaqësuese e Përhershme